



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 7 maj 2015, në mbledhjen XII – të (dymbëdhjetë) të Komitetit për Komunitete.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.05'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Shaban Ahmeti, kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht z.Bahri Selimi, z.Mefail Rama, z.Shaban Osmani, z.Radisav Perović. z.Xhafer Ademi dhe z.Xhevdet Beselica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm z. Devolle Topçiu, përfaqësuese e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, z.Habi Sylejmani, Komanda Rajonale Kufitare – Veriu, z.Bekim Karaxhija, dhe z.Muhamed Fetahi, OSBE, z.Bálint Nèmetm, KFOR, LMT.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 07 prill 2015

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Shqyrtimi i mundësive për organizimin e një takimi pune me përfaqësuesit e Komiteteve për Komunitete të Komunave të regjionit të Prishtinës

Kryesuesi z.Shaban Ahmeti, theksoi, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës ne sot mund të bashkëbisedojmë dhe të mundohemi të gjejmë mënyrën më të mirë për organizimin e një takimi me karakter konsultativ me kryesuesit e Komiteteve për Komunitete të Komunave të regjionit të Prishtinës duke përfshirë edhe vendin e mbajtjes së takimit por edhe sigurimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të organizimit, për më shumë sqarime rreth këtij propozimi, fjalën ja jap zyrtarit Ligjor z. Faik Gashi.

z.Faik Gashi, zyrtar Ligjor në Komunën e Podujevës, theksoi, lidhur me këtë propozim ne kemi menduar të organizojmë një takim konsultativ me Kryesuesit e Komiteteve për Komunitete të Komunave të regjionit të Prishtinës duke mos

përrjashtuar edhe ndonjë anëtarë të atyre Komiteteve varësisht prej sigurimit të mjeteve buxhetore. Fokusi është menduar të jetë shkëmbimi i përvojave të ndryshme të Komiteteve për Komunitete të regjionit të cekur. Gjithashtu duke qenë dëshmitarë të emigrimit të qytetarëve në kohët e fundit, jemi në dijeni se ka pasur edhe persona nga Komunitetet RAE të cilët kanë emigruar, mirëpo duke qenë edhe dëshmitarë se një pjesë e tyre tani veç kanë filluar të kthehen duke përfshirë edhe nga Komuniteti RAE, kemi paraparë të debatojmë rreth identifikimit të masave dhe veprimeve në funksion të riadhesimit dhe integritit të atyre që kthehen dhe bashkërisht t'i identifikojmë disa masa në mënyrë që të kthyerit të riintegrohen sa më shpejt që të jetë e mundur. Vlen të ceket se takime të tilla në regjione të ndryshme janë mbajtur në të kaluarën dhe kanë qenë shumë frytdhënëse. Rreth financimit të këtij takimi ne kemi biseduar me përfaqësuesin e OSBE-së për gjetjen e mënyrës së financimit nga ana e OSBE-së, por nëse nuk realizohet kjo atëherë ne duhet të mundohemi të gjejmë mënyrë tjetër.

z.Bekim Karaxhija, përfaqësues i OSBE-së, theksoi, sa i përket aktivitetit që e përmendi parafolësi ne si OSBE e kemi përshëndetur këtë iniciativë aq më shumë kur kjo është ndërmarrë nga vetë Komuna e Podujevës përkatësisht Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Komitetit për Komunitete. Është e vërtetë se ne kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm me parafolësin. Kjo ide neve si Zyre rajonale e OSBE-së në Mitrovicë na ka pëlqyer shumë, mirëpo për shkak të strukturimit të OSBE-së në Kosovë, Komuna e Podujevës bënë pjesë në Qendrën rajonale të regjionit të Mitrovicës, ne realisht jemi të gatshëm të shqyrtojmë këtë mundësi dhe të mbështesim me mjete financiare këtë iniciativë por vetëm nëse jeni të gatshëm që të përfshihen edhe Komunitet e regjionit të Mitrovicës, pra kryesuesit e Komiteteve për Komunitete të Komunave të regjionit të Prishtinës dhe të regjionit të Mitrovicës. Ne kemi vërejtur se Komitetit për Komunitete i Komunës së Podujevës është shembull për Komitetet tjera të Komunave të Kosovës, andaj besoj se do të mund të organizoj një takim të tillë i cili pa dyshim se do të ishte i mirëseardhur për Komitetet në përgjithësi por edhe për OSBE-në në veçanti. Pra ne jemi të interesuar për realizimin e këtij takimi, ndërsa për detaje tjera rreth organizimit dhe punëve teknike sigurisht se do të diskutojmë në ditët në vijim.

z.Faik Gashi, zyrtar Ligjor në Komunën e Podujevës, dëshira jonë do të ishte të përfshiheshin të gjitha regjionet mirëpo kjo varet krejt nga aspekti financiarë, por si do që të jetë për ne nuk paraqet aspak problem a është regjioni i Prishtinës apo regjioni i Mitrovicës. Rreth vendit, kohës së mbajtjes së takimit dhe detaje tjera organizative ne mund të bisedojmë në ditët në vijim, mirëpo në këtë mbledhje ne vetëm mund të marrim një miratim sa i përket kësaj iniciative. Meqë prezentë në këtë mbledhje është edhe përfaqësuesja e MKK-së, ne mund të kërkojmë që brenda mundësive të involvohet edhe Ministria për Komunitete dhe Kthim, pra organizatore e këtij takimi të jenë Komuna e Podujevës, OSBE –ja dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim.

z.Devolle Topçiu, përfaqësuese e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, theksoi, ne si Ministri tani veç jemi kompletuar sa i përket stafit udhëheqës, dua të them se është emëruar Ministri dhe dy Zëvendësministra ku njëri prej tyre është nga Komunitetit RAE nga i cili mund të keni shumë më shumë pika të përbashkëta sa i përket një propozimi të tillë e që unë personalisht mendoj se do të hasni në mirëkuptim me atë në qoftë se i drejtoheni me ndonjë shkresë apo edhe

drejtpërsëdrejti. Pra kur e them këtë mendoj se do të ishte mirë që të lëmë një takim në Ministri në mënyrë që të bisedojmë edhe me Ministrin ose Zëvendësministrin e MKK-së. Unë personalisht më shumë do t'i jepja prioritet OSBE-së sa i përket financimit të këtij takimi mes kryesuesve të Komiteteve për Komunitete të Komunave të regjioneve të Prishtinës dhe regjionit të Mitrovicës, sepse Ministria në fokus point e ka Kthimin e Komuniteteve.

z.Faik Gashi, zyrtar Ligjor në Komunën e Podujevës, konsideroj se nuk kemi çka të shtojmë më shumë rreth kësaj, por vetëm mbete që të diskutojmë edhe njëherë bashkërisht Komuna e Podujevë, OSBE-ja dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim. Pra kjo le të jetë si konkludim i këtij Komitetit.

4. Caktimi i datës për organizimin e vizitës Komuniteteve pakicë

Kryesuesi z.Shaban Ahmeti, e paraqiti fjalë hyrëse rreth vizitave të parapara në fshatra dhe lagjet ku jetojnë komunitetet pakicë si, Metergoc, Orllan, Batllavë etj. gjithashtu i njoftoj të pranishmit për vizitat e ngjashme në vitet e kaluara nga të cilat janë ndarë të gjithë të kënaqur, sepse nga afër i kemi parë hallet, brengat dhe nevojat e komuniteteve. Propozoj që të ftohen në vizitë edhe përfaqësues nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe nga Ministria për Komunitete dhe Kthim por edhe përfaqësues nga ndonjë Ministri tjetër, që do t'i bëhet fshatrave dhe lagjeve që jetojnë Komunitetet pakicë në territorin e Komunës së Podujevës. Ne sot kemi detyrë që vetëm ta caktojmë datën dhe kohën e nisjes, ndërsa për itinerarin dhe detaje tjera do të vendosen bashkërisht nga ne, paraprakisht duhet të kontaktoj edhe me z.Radisav Perović se kur është i lirë dhe kur mund të na pret në vizitën që do t'ia bëjmë atij.

z.Faik Gashi, zyrtar Ligjor në Komunën e Podujevës, sa për njoftim të përfaqësueses së Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, z.Radisav Perović, është nga komunitetit Serb dhe jetojnë tri familje në Lagjen Sekiraqa në fshatin Metergoc i cili gjendet në vijën kufitare me Serbinë, andaj pyes e konsideroni ju si Ministri, të vlefshme këtë që ta njoftoni Ministrin në mënyrë që ai të shqyrton mundësin për pjesëmarrje në këtë vizitë, nëse jo, së paku do të ishte mirë të na bashkëngjitej një përfaqësues i Ministrisë tuaj. Pra propozoj që mos të caktohet data sot por të lihet pasi që z. Devolle Topçiu të bisedon me Ministrin e MKK dhe të na njofton neve për pjesëmarrjen ose jo të Ministrit, pastaj unë do t'ju njoftoj dhe do t'ju dërgoj ftesat të gjithëve.

z.Devolle Topçiu, përfaqësuese e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, theksoi, sikurse unë ashtu edhe Ministri është i njoftuar për këtë Lagje për të cilën i posedon raportet dhe fotografitë përkatëse, unë mund t'ju them se unë do të njoftoj Ministrin për këtë vizitë kurse nuk mund t'ju them asgjë se a do të merr apo jo pjesë ai në këtë vizitë.

5. Të ndryshme

Kryesuesi z.Shaban Ahmeti, i njoftoj të pranishmit për takimin e organizuar nga OSBE-ja në Prishtinë, dhe shtoi, kemi diskutuar çështje të ndryshme mirëpo ndër më të rëndësishmet ka qenë edhe planifikimi i buxheteve vjetore të Komiteteve për Komunitete në Komuna, andaj është mirë që edhe ne si Komitet për Komunitete i

Komunës së Podujevës sa më shpejt që të jetë e mundur të përgatitim projektbuxhetin në mënyrë që të jetë i gatshëm për përfshirje në projektbuxhetin e Komunës për vitin e ardhshëm. Këtë që e thash janë duke e aplikuar shumica e Komiteteve të komunave të Kosovës andaj do të ishte mirë të fillojmë edhe ne. Gjithashtu i njoftoj të pranishmit edhe për debatin e zhvilluar rreth përfaqësimit të gjinisë femërore në Komitete dhe në struktura tjera të Komuniteteve.

z.Faik Gashi, zyrtar Ligjor në Komunën e Podujevës, theksoi, kjo çështje është shtruar disa herë nga ana e Kryesuesit të Komitetit, mirëpo unë disa herë e kam potencuar se as Kuvendi i Komunës nuk ka vijë të veçantë të buxhetit, mirëpo absolutisht asnjë aktivitet i këtij Komiteti deri më tani nuk është cunuar për shkak të mjeteve buxhetore. Pra këtë çështje mund ta shqyrtojmë në ndonjë mbledhje të ardhshme të Komitetit sepse ende konsideroj se është herët ngase nuk ka filluar ende procesi i buxhetimit përkatësisht nuk ka dalë Korniza Afatmesme Buxhetore, unë do j'u informoj për këtë dhe ky Komitet mund të cakton një Grup punues për përcjelljen e procesit dhe përgatitjen e propozimeve të projektbuxhetit të Komitetit.

Kryesuesi z.Shaban Ahmeti, theksoi, të gjithë përfaqësuesit e Ministrive përkatëse dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal kanë dhënë fjalë të mira sa i përket Komitetit për Komunitete të Komunës së Podujevës, mirëpo unë konsideroj se edhe çështja e buxhetit është mirë të përcaktohet apo ndryshe, të ndahet një vijë buxhetore për Komitetin për Komunitete.

z.Faik Gashi, zyrtar Ligjor në Komunën e Podujevës, theksoi, jeni në dijeni se në mbledhjen e fundit është ngritur Grupi punues për hartimin e propozimit të planit të veprimit për integrimin e komuniteteve RAE, mbi bazën e Strategjisë Kombëtare. Propozimet e bëra në atë mbledhje ju kanë propozuar edhe Kryetarit të Komunës i cili me vendim e ka ngritur këtë Grup prej 15 anëtarëve, ku kryesues është z.Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komonale për Komunitete dhe Kthim, dhe tani ka mbetur që ky Grup të filloj me punë.

z.Bekim Karaxhija, përfaqësues i OSBE-së, e përgëzoi Komunën sa i përket ngritjes së Grupit punues për hartimin e propozimit të planit të veprimit për integrimin e komuniteteve RAE, dhe e falënderoi shefin e Zyrës Komonale për Komunitete dhe Kthim dhe Komitetin për Komunitete të Komunës së Podujevës për gatishmërinë që kanë treguar për bashkëpunim me OSBE-në që në momentin që ne e kemi propozuar këtë plan, ai propozim është marrë me seriozitet dhe është miratuar edhe nga ana e Kryetarit të Komunës, kështu që vetëm ju dëshiroj punë të mbarë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:35

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-006-48774
Podujevë,
07 maj 2015**

**Kryesuesi i Komitetit
Shaban Ahmeti**